



**ARTICLES OF INCORPORATION AND
ARTICLES OF ASSOCIATION
OF THE LIMITED LIABILITY
COMPANY
DIAVERUM ALBANIA SHPK**

**OWNERSHIP, SCOPE OF ACTIVITY,
REGISTERED OFFICE**

**Article 1
Sole Shareholder**

- 1.1 The company Diaverum Albania SHPK (the “**Company**”) is established on the date hereof by the following sole shareholder:

Diaverum AB, a limited liability company duly established and operating under the laws of Sweden, registered with the Swedish Companies Registration Office under registration number 559140-5344, and with registered office at Hyllie Boulevard 53, 215 37, Malmö, Sweden (the “**Sole Shareholder**”).

**Article 2
Name**

- 2.1 The name of the Company is Diaverum Albania SHPK.
- 2.2 In all the documents, invoices, advertisements, and publications issued by the Company, regardless of the means for transmission, the name of the Company should be preceded or followed by:
- i. the words “*Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*” or “*SHPK*”;
 - ii. its unique identification number (NUIS);

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
DIAVERUM ALBANIA SHPK**



**PRONËSIA, FUSHA E AKTIVITETIT,
SELIA**

**Neni 1
Ortaku i Vetëm**

- 1.1 Shoqëria Diaverum Albania SHPK (“**Shoqëria**”) është themeluar në këtë datë nga ortaku i vetëm i mëposhtëm:

Diaverum AB, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Suedisë, e regjistruar pranë Regjistrisë Suedeze të Shoqërive me numër regjistrimi 559140-5344 dhe me seli në Hyllie Boulevard 53, 215 37, Malmö, Suedi (“**Ortaku i Vetëm**”).

**Neni 2
Emri**

- 2.1 Emri i Shoqërisë është Diaverum Albania SHPK.
- 2.2 Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamimet dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyrat e transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të pasohet nga:
- i. fjalët “*Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*” ose “*SHPK*”;
 - ii. numrin unik të identifikimit (NUIS);



iii. the registered capital and the paid in capital of the Company;

iv. the address of its registered seat; and

v. a note that the Company is under liquidation, if applicable.

iii. kapitalin e regjistruar dhe i paguar i Shoqërisë;

iv. adresën e selisë; dhe

v. një shënim që Shoqëria është në likuidim, nëse është e zbatueshme.

Article 3 Legal Form

3.1 The Company is organized under the form of a Limited Liability Company in accordance with the commercial legislation in force in the Republic of Albania.

3.2 The Company may be transformed into another legal form in compliance with the Albanian legislation.

Article 4 Legal Grounds

4.1 The Company will carry out its activity in compliance with these Articles of Association, the Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies", as amended ("Company Law") and other applicable provisions of Albanian law.

Article 5 Duration of Activity

5.1 The duration of the Company is unlimited.

Article 6 Registered Office and Other Places of Activity

Neni 3 Forma Ligjore

3.1 Shoqëria organizohet në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4 Baza Ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("**Ligji për Shoqëritë Tregtare**") dhe dispozita të tjera në fuqi të ligjit shqiptar.

Neni 5 Kohëzgjatja e Aktivitetit

5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 6 Selia dhe Vendet e Tjera të Aktivitetit

6.1 The registered office of the Company is at the address: Rruga Papa Gjon Pali, Pallati 11/1, Kati 2, (ish Telesport), Tirana, Albania.

6.2 Branch offices and subsidiaries may be established or closed by resolution of the Sole Shareholder.

6.3 Notwithstanding the above, the Administrator(s) may establish or close secondary addresses of the Company in Albania.

Article 7 Object

7.1 The object of the Company is the provision and management of Hemodialysis and Hemodiafiltration (HDF) services, including specialized clinical care for patients suffering from chronic kidney disease; the diagnosis, monitoring and management of kidney diseases; the prevention and treatment of related complications; the establishment, maintenance and monitoring of vascular access; the supply of medical equipment, technology and materials; the provision of technical support and specialized medical and nursing personnel; as well as the provision of support and counselling services to patients, with the aim of ensuring the continuity, quality and safety of treatment.

7.2 The Company will perform trade within the scope of its registered business activities, including the import and export of goods and services relating to healthcare, renal care and dialysis treatment; intermediation and representation in the foreign trade of

6.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Papa Gjon Pali, Pallati 11/1, Kati 2, (ish Telesport), Tiranë, Shqipëri.


6.2 Degët dhe filialet mund të krijohen ose mbyllen me vendim të Ortakut të Vetëm.

6.3 Pavarësisht parashikimit më sipër, Administratori(ët) mund të krijojnë ose mbyllin adresa dytësore të Shoqërisë në Shqipëri.

Neni 7 Objekti

7.1 Objekti i Shoqërisë është Ofrimi dhe menaxhimi i shërbimit të Hemodializës dhe Hemodiafiltrimit (HDF), përfshirë kujdesin klinik të specializuar për pacientët me sëmundje renale kronike, diagnostikimin, monitorimin dhe menaxhimin e sëmundjeve të veshkave, parandalimin dhe trajtimin e komplikacioneve të lidhura me to, krijimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e aksesit vaskular, furnizimin me pajisje, teknologji dhe materiale mjekësore, mbështetjen teknike, personelin e specializuar mjekësor dhe infermieror, si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe këshilluese për pacientët, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë, cilësisë dhe sigurisë së trajtimit

7.2 Shoqëria do të kryejë tregti brenda fushës së aktiviteteve të regjistruara, duke përfshirë importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve që lidhen me kujdesin shëndetësor, kujdesin renal dhe trajtimin me dializë; ndërmjetësimin dhe përfaqësimin në tregtinë e jashtme të



such goods and services; research, dissemination and use of information and know-how in the medical, economic and scientific fields; representation of foreign entities within the scope of the registered activity; and carrying out investment activities domestically and abroad in connection with the registered activity. Additionally, the Company may offer advisory, educational, preventive and supportive services in the field of nephrology and renal care, as well as any other related or complementary activity that contributes to the improvement of care for patients with kidney diseases.

7.3 In order to achieve the above-mentioned scope, the Company is entitled to:

- a. carry out business related to the Company's scope in Albania or abroad;
- b. conclude all kind of contracts or agreements with foreign or Albanian natural persons, public and private legal entities, including companies and the state;
- c. establish all kinds of companies or to participate in Albanian or foreign companies or joint ventures or various types of businesses, having the same or similar objects;
- d. establish branch offices or agencies in Albania or abroad;
- e. grant or obtain loans and securities, subject to Articles 12.3 and 12.4.

7.4 The Company may carry out in a secondary way, and any way only for the

këtyre mallrave dhe shërbimeve; kërkimin, shpërndarjen dhe përdorimin e informacionit dhe njohurive (know-how) në fushat mjekësore, ekonomike dhe shkencore; përfaqësimin e subjekteve të huaja brenda fushës së aktivitetit të regjistruar; dhe kryerjen e veprimtarive investuese brenda dhe jashtë vendit në lidhje me aktivitetin e regjistruar. Gjithashtu, Shoqëria mund të ofrojë shërbime këshillimore, edukative, parandaluese dhe mbështetëse në fushën e nefrologjisë dhe kujdesit renal, si dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur ose plotësues që kontribuon në përmirësimin e kujdesit ndaj pacientëve me sëmundje të veshkave.

7.3 Për të arritur qëllimin e lartpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:

- a. të kryejë veprimtari tregtare në lidhje me qëllimin e Shoqërisë në Shqipëri ose jashtë saj;
- b. të lidhë të gjitha llojet e kontratave ose marrëveshjeve me persona fizikë të huaj ose shqiptarë, persona juridikë publikë dhe privatë, përfshirë shoqëritë tregtare dhe shtetin;
- c. të themelojë shoqëri të çdo lloji ose të marrë pjesë në shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta (*joint venture*) ose biznese të llojeve të ndryshme shqiptare ose të huaja, me objekte të njëjta ose të ngjashme;
- d. të krijojë degë ose agjenci në Shqipëri ose jashtë saj;
- e. të japë ose të marrë hua dhe garanci, në përputhje me Nenet 12.3 dhe 12.4.

7.4 Shoqëria mund të kryejë, në mënyrë dytësore dhe vetëm për qëllimin e arritjes

purpose to reach the Company's business purpose, all the auxiliary or connected operations, as well as any commercial, industrial, financial operations and transactions concerning movable and immovable property which may be deemed as necessary or appropriate for the achievement of the corporate objects.

- 7.5 The Company shall not, without the prior approval of the Sole Shareholder, cease to conduct its business or make any material change to the general nature, scope, or principal activities of the Company. Such approval shall be reserved for the Sole Shareholder and may not be delegated to the Administrators.

Article 8 Capital

- 8.1 The registered capital of the Company on the date hereof is ALL 10,000 (ten thousand Albanian Lek) and consists of 1 (*one*) share owned by the Sole Shareholder, representing 100% of the share capital.
- 8.2 The capital will be paid in monetary value in one of more instalments within a year upon its registration, in the bank account of the Company opened with any bank in Albania.

Article 9 Transfer of Capital Shares / Restrictions on Transfer

- 9.1 The Sole Shareholder is the exclusive owner of the entire share of the registered capital of the Company.

së objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, të gjitha veprimet tregtare ndihmëse ose të lidhura, si dhe çdo veprim dhe transaksion tregtar, industrial, financiar, lidhur me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që mund të konsiderohen të nevojshme ose të përshtatshme për realizimin e objektivave të saj tregtar.

- 7.5 Shoqëria nuk do të pushojë së ushtruari aktivitetin e saj tregtar ose të bëjë ndonjë ndryshim thelbësor në natyrën e përgjithshme, fushëveprimin ose aktivitetet kryesore të Shoqërisë, pa miratimin paraprak të Ortakut të Vetëm. Ky miratim i rezervohet Ortakut të Vetëm dhe nuk mund t'u delegohet Administratorëve.

Neni 8 Kapitali

- 8.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë në këtë datë është 10,000 lekë (dhjetë mijë lekë) dhe nga data e këtij dokumenti, përbëhet nga 1 (një) kuotë në pronësi të Ortakut të Vetëm që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar.
- 8.2 Kapitali do të paguhet me para në një ose më shumë kështe në llogarinë bankare të Shoqërisë të hapur pranë çdo banke në Shqipëri, brenda një viti nga regjistrimi i saj.

Neni 9 Transferimi i Kuotave të Kapitalit / Kufizimet në transferim

- 9.1 Ortaku i Vetëm është pronari i vetëm i të gjithë kuotës së kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

- 9.2 The share of the registered capital may be freely transferred, in whole or in part, to third parties only by written document.

- 9.2 Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, tërësisht ose pjesërisht, tek të tretë vetëm me dokument të shkruar.

Article 10 Capital Increase

- 10.1 The Sole Shareholder may increase its contribution in the share of the registered capital by the amount and under such terms as provided in the resolution of the Sole Shareholder. The Sole Shareholder's contribution may consist in all forms of assets permitted by the law, including contribution in kind.
- 10.2 The increases in Company's share capital may also be executed through the offering for subscription of new shares to any third party. New shareholders shall be accepted and approved as such by resolution of the Sole Shareholder.
- 10.3 The Sole Shareholder may finance the Company by interest-bearing or non-interest-bearing payments, either as capital contributions or otherwise, even subject to a reimbursement obligation, in compliance with the laws and regulations currently in force.

Article 11 Capital Decrease

- 11.1 Based on the resolution of the Sole Shareholder, decrease of the registered capital shall be made in compliance with the commercial legislation.

Neni 10 Zmadhimi i kapitalit

- 10.1 Ortaku i Vetëm mund të zmadhojë kontributin e tij në pjesën e kapitalit të regjistruar në shumën dhe sipas kushteve të parashikuara në vendimin e Ortakut të Vetëm. Kontributi i Ortakut të Vetëm mund të përbëhet nga të gjitha format e kontributeve të lejuara nga ligji, duke përfshirë kontributin në natyrë.
- 10.2 Zmadhimet e kapitalit të Shoqërisë mund të realizohen edhe nëpërmjet ofrimit për nënshkrim të kuotave të reja për çdo palë të tretë. Ortakët e rinj mund të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 10.3 Ortaku i Vetëm mund të financojë Shoqërinë me pagesa me interes ose pa interes, qoftë si kontribute kapitale ose ndryshe, madje edhe si subjekt i një detyrimi rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Neni 11 Zvogëlimi i Kapitalit


- 11.1 Bazuar në vendimin e Ortakut të Vetëm, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar.

GOVERNANCE STRUCTURE

Article 12

Sole Shareholder Resolutions

- 12.1 All key decisions regarding the Company's operations shall be made through resolutions adopted by the Sole Shareholder, which serves as the Company's highest governing body and has the authority to decide on main matters related to its activities. The resolutions of the Sole Shareholder must be registered in a register of resolutions, the data of which may not be altered or erased. For as long as there is one shareholder in the Company, the resolutions of the general assembly shall take the form of a single document executed by the Sole Shareholder, and no minutes shall be taken.
- 12.2 The rights and obligations of the Sole Shareholder in the Company are exercised directly by the legal representative(s) of the Sole Shareholder or by any individual authorised by the competent corporate body of the Sole Shareholder.
- 12.3 Only the Sole Shareholder shall be entitled to:
- a. define the trade policies of the company;
 - b. amend or adopt new Articles of Association;
 - c. appoint and dismiss the administrators;
 - d. appoint and dismiss the liquidators and the auditors;
 - e. determine the remuneration for the persons mentioned in letters "c" and "d" of this paragraph;
 - f. supervise the implementation of business policies by



STRUKTURA DREJTUESE

Neni 12

Vendimet e Ortakut të Vetëm


- 12.1 Vendimet kryesore në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë merren me vendim të Ortakut të Vetëm, i cili është organi më i lartë i Shoqërisë dhe ka të drejtë të vendosë për çështjet kryesore që lidhen me veprimtarinë e saj. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Për sa kohë që Shoqëria ka vetëm një ortak, vendimet e asamblesë së përgjithshme do të kenë formën e një dokumenti të vetëm të nënshkruar nga Ortaku i Vetëm, dhe nuk do të mbahet procesverbal.
- 12.2 Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm në Shoqëri ushtrohen drejtpërdrejt nga përfaqësuesi(t) ligjor i Ortakut të Vetëm ose nga çdo individ i autorizuar nga organi kompetent i Ortakut të Vetëm.
- 12.3 Vetëm Ortaku i Vetëm ka të drejtë të:
- a. përcaktojë politikat tregtare të Shoqërisë;
 - b. ndryshojë ose miratojë Statutin e ri të Shoqërisë;
 - c. emërojë dhe shkarkojë administratorët;
 - d. emërojë dhe shkarkojë likuiduesit dhe auditorët;
 - e. përcaktojë shpërblimin për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të këtij paragrafi;
 - f. mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare nga administratorët, duke

- administrators, including the preparation of the annual financial statements and the performance report;
- g. approve the annual financial statements and the reports on the progress of activity;
- h. approve the increase and/or decrease the registered capital;
- i. approve the division of shares and their cancellation;
- j. resolve on a merger, spin-off, dissolution and any kind of transformation of the Company;
- k. resolve on acquisition, sale and encumbrance of real property and other immovable assets of the Company;
- l. represent the Company in court and other proceedings against the administrators;
- m. adopt the procedural rules of the meeting of the general assembly;
- n. approve the granting of loans and securities by the Company, without prejudice to letter "r" below;
- o. decide on any other matters reserved to the general assembly under the law and/or these Articles of Association or for which the resolution has not been reserved to any other body by the law and/or these Articles of Association;
- p. approve any sale, transfer, assignment, lease, licence, pledge, disposal or other divestment of (i) all or any substantial part of the Company's business or undertaking, or (ii) any assets of the Company where the transaction, considered alone or together with other related
- përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportin e veprimtarisë;
- g. miratojnë pasqyrat financiare vjetore dhe raportet për ecurinë e veprimtarisë;
- h. miratojnë zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- i. miratojnë ndarjen e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. vendosë për bashkimin, *spin-off*, shpërbërjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- k. vendosë për përvetsimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuri të paluajtshme të Shoqërisë;
- l. përfaqësojë Shoqërinë në gjykatë dhe procese të tjera kundër administratorëve;
- m. miratojnë rregullat procedurale të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme;
- n. miratojnë dhënien e huave dhe garancive nga Shoqëria, pa paragjykuar shkronjën "r" më poshtë;
- o. vendosë për çdo çështje tjetër që i rezervohet asamblesë së përgjithshme sipas ligjit dhe/ose këtij Statuti ose për të cilat vendimi nuk i është rezervuar ndonjë organi tjetër me ligj dhe/ose në këtë statut.;
- p. miratojnë çdo shitje, transferim, cedim, dhënie me qira, licencim, lënie peng, tjetërsim ose çdo disponim tjetër të (i) të gjithë ose një pjese thelbësore të veprimtarisë ose ndërmarrjes së Shoqërisë, ose (ii) çdo aktivi të Shoqërisë, kur transaksioni, i marrë vetëm ose së bashku me transaksione të tjera të lidhura, është material në lidhje me veprimtarinë ose aktivet e

transactions, is material in relation to the Company's business or assets, save for Intra Group Transactions and transactions carried out in the ordinary course of the Company's business on arm's length terms and in accordance with the Company's annual budget;

- q. approve any disposal, transfer or encumbrance of any shares or quotas held by the Company in other companies, save for Intra Group Transactions;
- r. approve the incurrence, assumption or guarantee of, or any other assumption of liability for, any financial indebtedness to third parties, including loans, credit facilities, bonds, notes, debentures or any other form of borrowed money, but excluding trade payables and other operating liabilities incurred in the ordinary course of the Company's day-to-day business on arm's length terms, save for Intra Group Transactions;
- s. approve any cessation of the Company's business or any material change to the general nature, scope or principal activities of the Company.

12.4 For the purposes of these Articles of Association, "Intra Group Transactions" means transactions with companies within the Diaverum group of companies, being companies directly or indirectly controlled by M42 Ltd. The matters set out in letters "p" to "s" of Article 12.3 are reserved to the Sole Shareholder and may not be delegated to the Administrator(s), and the Company shall not undertake any such matter without the prior



Shoqërisë, me përjashtim të Transaksioneve Brenda Grupit dhe të transaksioneve të kryera në rrjedhën e zakonshme të veprimtarisë së Shoqërisë me kushte tregu dhe në përputhje me buxhetin vjetor të Shoqërisë;

- q. miratojë çdo tjetërsim, transferim ose vendosje barre mbi kuotat ose aksionet që Shoqëria mban në shoqëri të tjera, me përjashtim të Transaksioneve Brenda Grupit;
- r. miratojë marrjen, përthithjen ose garantimin, si edhe çdo marrje tjetër përgjegjësie, për çdo detyrim financiar ndaj palëve të treta, përfshirë hua, linja krediti, obligacione, letra borxhi ose çdo formë tjetër të mjeteve të marra hua, por përjashtuar detyrimet tregtare dhe detyrimet e tjera operationale të krijuara në rrjedhën e zakonshme të veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë me kushte tregu, me përjashtim të Transaksioneve Brenda Grupit;
- s. miratojë çdo ndërprerje të veprimtarisë së Shoqërisë ose çdo ndryshim material të natyrës së përgjithshme, fushës ose veprimtarive kryesore të Shoqërisë.

12.4 Për qëllimet e këtij Statuti, "Transaksione Brenda Grupit" nënkupton transaksionet me shoqëri brenda grupit Diaverum, pra shoqëri të kontrolluara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga M42 Ltd. Çështjet e parashikuara në shkronjat "p" deri "s" të Nenit 12.3 i rezervohen Ortakut të Vetëm dhe nuk mund t'i delegohen Administratorit(ëve), dhe Shoqëria nuk mund të ndërmarrë asnjë çështje të tillë pa miratimin paraprak me shkrim të Ortakut

written approval of the Sole Shareholder.

12.5 The Sole Shareholder may adopt resolutions at any time. Each Administrator individually shall have the right to request in writing that a resolution be adopted or that a general assembly be convened. Should the Company at any time have more than one shareholder, any shareholder may request in writing that the Administrator(s) convene a general assembly and, if the Administrator(s) fail to convene it within fourteen (14) days of receipt of the request, the requesting shareholder(s) may convene the meeting themselves at the Company's expense. Notice of a general assembly shall be given not less than seven (7) days prior to the meeting, in writing to each shareholder at its registered address, and shall specify the time, place and agenda of the meeting and be accompanied by any proposed resolutions and such other information as may be required by applicable law.

Article 13 Administrator

- 13.1 The Company's daily administration shall be entrusted to one (1) or more Administrators, appointed by resolution of the Sole Shareholder. The Administrator of the parent company may not be appointed as Administrator of the subsidiary and vice versa.
- 13.2 The Administrator(s) shall have the powers necessary for the ordinary and daily management of the Company and for carrying out all actions required for the achievement of the Company's corporate object, except for matters which by law, these Articles of Association or resolutions of the Sole

të Vetëm.

12.5 Ortaku i Vetëm mund të marrë vendime në çdo kohë. Çdo Administrator, veç e veç, ka të drejtën të kërkojë me shkrim marrjen e një vendimi ose thirrjen e asamblesë së përgjithshme. Nëse-Shoqëria ka në çdo kohë më shumë se një ortak, çdo ortak mund t'i kërkojë me shkrim Administratorit(ëve) thirrjen e asamblesë së përgjithshme dhe, nëse Administratori(ët) nuk e thirr(in) mbledhjen brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga marrja e kërkesës, ortaku(t) kërkesues mund të thërrasin vetë mbledhjen me shpenzimet e Shoqërisë. Njoftimi për asamblenë e përgjithshme dërgohet jo më pak se shtatë (7) ditë përpara mbledhjes, me shkrim, te secili ortak në adresën e tij të regjistruar, dhe duhet të përcaktojë kohën, vendin dhe rendin e ditës, si edhe të shoqërohet me vendimet e propozuara dhe informacionin tjetër të kërkuar nga legjislacioni i zbatueshëm.

Neni 13 Administratori

- 13.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do t'i caktohet një (1) ose më shumë Administratorëve, të emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm. Administratori i shoqërisë mëmë nuk mund të caktohet si Administrator i filialit dhe anasjelltas.
- 13.2 Administratori(ët) do të ketë/në kompetencat e nevojshme për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për realizimin e objektivit të veprimtarisë së Shoqërisë, me përjashtim të çështjeve që, sipas ligjit, këtij Statuti ose vendimeve të

Shareholder, are reserved to the Sole Shareholder, or matters which must be performed jointly with another person designated by the Sole Shareholder.

Subject to the representation rules set out in Article 13.4 or in accordance with Article 13.5 below, the Administrators may, by power of attorney, delegate specific powers relating to the management or legal representation of the Company to third party individuals, within the limits determined by the Administrators and/or the Sole Shareholder.

13.3 In particular, the Administrator(s) shall be empowered to:

- a. manage the day-to-day business of the Company in compliance with the law, these Articles of Association and the resolutions or instructions of the Sole Shareholder adopted from time to time;
- b. represent the Company before third parties, public authorities, courts, banks and any other institutions, subject to the rules set out in these Articles of Association, including Articles 12.3 and 12.4;
- c. open, operate and close bank accounts of the Company;
- d. enter into, amend and terminate agreements with third parties, subject to Articles 12.3 and 12.4;
- e. issue invoices, settle due debts of the Company and accept securities from third parties;
- f. hire and dismiss Company's staff and determine wages and salaries and other remunerations in line with the policies and guidelines adopted by

Ortakut të Vetëm, i rezervohen Ortakut të Vetëm, ose që duhet të kryhen bashkërisht me çdo person tjetër të caktuar nga Ortaku i Vetëm.

Në përputhje me rregullin e përfaqësimit të përbashkët të parashikuar në nenin 13.4 ose në përputhje me 13.5 më poshtë, Administratorët mund të delegojnë, me prokurë/autorizim, kompetenca të caktuara lidhur me administrimin ose përfaqësimin ligjor të Shoqërisë të palë të treta individë, brenda kufijve të përcaktuar nga Administratorët dhe/ose Ortaku i Vetëm.

13.3 Në veçanti, Administratori(ët) ka(në) kompetencë të:

- a. administroj(n)ë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë në përputhje me ligjin, këtë Statut dhe vendimet ose udhëzimet e Ortakut të Vetëm të miratuara herë pas here;
- b. përfaqësoj(n)ë Shoqërinë përpara palëve të treta, autoriteteve publike, gjykatave, bankave dhe çdo institucioni tjetër, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut, përfshirë Nenet 12.3 dhe 12.4;
- c. hapin, operojnë dhe mbyllin llogaritë bankare të Shoqërisë;
- d. lidhin, ndryshoj(n)ë dhe zgjidhin marrëveshje me palë të treta, në përputhje me Nenet 12.3 dhe 12.4;
- e. lëshoj(n)ë fatura, shlyejnë detyrimet e maturuara të Shoqërisë dhe pranojnë garanci ose kolaterale nga palë të treta;
- f. punësoj(n)ë dhe shkarkojnë nga puna punonjësit e Shoqërisë dhe përcaktojnë pagat, shpërblimet dhe përfitimet e tjera, në përputhje me politikën dhe

the Sole Shareholder from time to time;

- g. take all other actions to ensure ordinary business of the Company in accordance with the law and these Articles of Associations;
- h. keeping of the accounting books as prescribed by the law and accounting principles;
- i. prepare the annual financial statements of the Company and audit of the same by external auditors if this is required by the law or by resolution of the Sole Shareholder;
- j. decide on any other matters which has been reserved to the Administrator by the law and/or these Articles of Association.

13.4 Notwithstanding the foregoing, if the Company has more than one Administrator, the Company shall be represented and bound vis-à-vis third parties only through the joint signature of any two (2) Administrators acting jointly, and no Administrator shall be entitled to represent or bind the Company acting alone, save that each Administrator may act individually in respect of administrative and ministerial matters, including the making of filings, declarations, registrations, applications and notifications with the National Business Centre, the tax, social security, customs, employment, health and other public authorities, the collection and submission of documents and routine correspondence with such authorities, and the certification of copies of the Company's documents. No Administrator may, acting alone, enter into or amend any agreement, incur any liability, dispose of or encumber any

udhëzimet e miratuara nga Ortaku i Vetëm herë pas here;

- g. kryej(n)ë çdo veprim tjetër të nevojshëm për veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë, në përputhje me ligjin dhe këtë Statut;
- h. mbaj(n)ë librat e kontabilitetit sipas kërkesave të ligjit dhe parimeve kontabël;
- i. përgatisin pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë dhe të organizojnë auditimin e tyre nga auditorë të jashtëm, nëse kjo kërkohej nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm;
- j. vendosin për çdo çështje tjetër që u rezervohet Administratorëve nga ligji, këto Statute ose vendimet e Ortakut të Vetëm.

13.4 Pavarësisht sa më sipër, në rast se Shoqëria ka emëruar më shumë se një Administrator, Shoqëria do të përfaqësohet dhe detyrohet ndaj të tretëve vetëm me nënshkrimin e përbashkët të cilëve do prej dy (2) Administratorëve që veprojnë bashkërisht, dhe asnjë Administrator nuk ka të drejtë të përfaqësojë ose të detyrojë Shoqërinë duke vepruar i vetëm, me përjashtim të faktit që çdo Administrator mund të veprojë individualisht për çështje administrative dhe procedurale, përfshirë kryerjen e depozitimeve, deklarimeve, regjistrimeve, aplikimeve dhe njoftimeve pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, organeve tatimore, sigurimeve shoqërore, doganave, organeve të punësimit, shëndetësisë dhe organeve të tjera publike, tërheqjen dhe dorëzimin e dokumenteve dhe korrespondencën rutinë me këto organe, si edhe vërtetimin e kopjeve të dokumenteve të Shoqërisë. Asnjë Administrator nuk mund, duke vepruar i vetëm, të lidhë ose të ndryshojë ndonjë marrëveshje, të krijojë

asset of the Company, or operate the Company's bank accounts.

13.5 The powers of the Administrators, including any limitations or specific authorisations, may be further detailed, amended or supplemented by resolution of the Sole Shareholder from time to time. Any such determinations shall be duly registered with the commercial register in Albania where required by law and shall not be construed as requiring an amendment to these Articles of Association.

13.6 Each Administrator shall hold office for a maximum period of five (5) years, with the possibility of reappointment, unless revoked or replaced earlier by resolution of the Sole Shareholder. The revocation of an Administrator by resolution of the Sole Shareholder shall not, in itself, be construed as an automatic termination of any separate contractual arrangement between the Administrator and the Company. Any applicable contractual notices, time limits and remuneration provided under such separate agreement, if any, shall be observed.

13.7 The first Administrators of the Company, appointed for an initial term of five (5) years, are:

1. **Klodian Shehi**, Albanian citizen, holder of passport with no. BI9283454, born on 28/03/1981;
2. **Ermioni Molla**, Albanian citizen, holder of passport with no. BA6384374, born on 19/06/1984;

ndonjë detyrim, të disponojë ose të vërë barrë mbi ndonjë aktiv të Shoqërisë, ose të operojë llogaritë bankare të Shoqërisë.

13.5 Kompetencat e Administratorëve, përfshirë çdo kufizim ose autorizim të posaçëm, mund të detajohen, ndryshohen ose plotësohen më tej me vendim të Ortakut të Vetëm herë pas here. Këto përcaktime do të regjistrohen rregullisht në regjistrin tregtar në Shqipëri kur kërkohet nga ligji dhe nuk do të konsiderohen se kërkojnë ndryshimin e këtij Statuti.

13.6 Çdo Administrator do të ushtrojë detyrën për një periudhë maksimale prej pesë (5) vitesh, me të drejtë riemërimi, përveç rastit kur shkarkohet ose zëvendësohet më herët me vendim të Ortakut të Vetëm. Shkarkimi i një Administratori me vendim të Ortakut të Vetëm nuk do të konsiderohet, në vetvete, si zgjidhje automatike e çdo marrëveshjeje të veçantë kontraktore ndërmjet Administratorit dhe Shoqërisë. Çdo njoftim, afat dhe shpërblim kontraktor i zbatueshëm sipas një marrëveshjeje të tillë të veçantë, nëse ka, do të respektohet.

13.7 Administratorët e parë të Shoqërisë, të emëruar për një mandat fillestar prej pesë (5) vitesh, janë:

1. **Klodian Shehi**, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me nr. BI9283454, lindur më 28/03/1981;
2. **Ermioni Molla**, shtetase shqiptare, mbajtëse e pasaportës me nr. BA6384374, lindur më 19/06/1984;

3. **Augustin-Viorel Simion**, Romanian citizen, holder of passport with no. 058288971, born on 24/11/1978.

Article 14
Fiduciary Duties and Liability

14.1 In addition to general fiduciary duties laid down in Article 13, 14, 15, 17 and 18 of the Company Law, the Administrator must:

- a. perform his duties established by the Company Law or these Articles of Associations in good faith and in the best interest of the Company as whole, paying particular attention to the impact of its operation on the environment;
- b. exercise his powers granted to them by the Company Law or these Articles of Associations, only for the purposes established herein;
- c. give adequate consideration to the matters to be decided;
- d. prevent and avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the Company;
- e. exercise due diligence and care of a reliable and conscientious businessperson and shall observe secrecy with regard to confidential matters;
- f. provide any information regarding business and economic data requested by the Sole Shareholder within reasonable time and in any case not later than 7 days. Information and data must be up-to-date.

3. **Augustin-Viorel Simion**, shtetas rumun, mbajtës i pasaportës me nr. 058288971, lindur më 24/11/1978.

Neni 14
Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

14.1 Përveç detyrave të përgjithshme të parimit të besnikërisë së parashikuar në Nenin 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori duhet:

- a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare ose në këtë Statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis;
- b. të ushtrojë kompetencat e tij të caktuara prej Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, vetëm për qëllimet e paracaktuara aty;
- c. të konsiderojë në mënyrë të përshtatshme çështjet që do të vendosen;
- d. të parandalojë dhe shmangë konfliktet aktuale dhe të mundshme ndërmjet interesave personale dhe atyre të Shoqërisë;
- e. të ushtrojë kujdesin e duhur të një tregtari të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm dhe të respektojë sekretin në lidhje me çështjet konfidenciale;
- f. të vendosë në dispozicion çdo informacion në lidhje me biznesin dhe të dhënat ekonomike të kërkuara nga Ortaku i Vetëm brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuar.

- 14.2 The Administrator shall, in the performance of their duties, be held liable to the Company for an act or omission which is reasonably related to the object of the Company, unless, pursuant to an inquiry and evaluation of the relevant information, the act or omission was found to be in good faith.

Article 15
Chartered Accountant(s)

- 15.1 An external auditor of the Company shall be appointed by resolution of the Sole Shareholder, if necessary. The mandate of the auditor, if appointed, must be renewed annually.

Article 16
Financial Year

- 16.1 The financial year of the Company activity coincides with the calendar year, beginning as of 1st January and ending on 31 December of each year.

Article 17
Financial Statements. Accounting

- 17.1 The Administrator is responsible for preparing the Company's financial statements, which must be submitted to the tax authorities before the end of March of the following year. The Sole Shareholder must approve the financial statements within the legally prescribed deadlines.
- 17.2 Accounting books should be kept in Albanian language and local currency (ALL). The Company may keep

- 14.2 Administratori, në kryerjen e detyrave të tij, do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për një veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me objektin e Shoqërisë, përveç rasteve kur, në bazë të një hetimi dhe vlerësimi të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi u konstatua se ishte në mirëbesim.

Neni 15
Eksperti(ët) Kontabël të autorizuar

- 15.1 Eksperti Kontabël i autorizuar (auditor i jashtëm) i Shoqërisë do të emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm, nëse është e nevojshme. Mandati i Eksperti Kontabël të autorizuar, nëse emërohet, duhet të rinovohet çdo vit.

Neni 16
Viti financiar

- 16.1 Viti financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe duke përfunduar më 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 17
Pasqyrat Financiare. Kontabiliteti

- 17.1 Administratori është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të Shoqërisë, të cilat duhet të dorëzohen pranë organeve tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës. Ortaku i Vetëm duhet të miratojë pasqyrat financiare brenda afateve të përcaktuara me ligj.
- 17.2 Librat kontabël duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta

separate accounts in foreign currency, which amounts need to be converted, every month in local currency.

- 17.3 Subject to Articles 12.3 and 12.4, the Company may receive financing from financial institutions operating in Albania or abroad. For this reason, the Sole Shareholder may pledge its shares in the Company as guarantee, or may decide to mortgage Company's assets.

Article 18 **Liquidation**

- 18.1 The Sole Shareholder has the authority to liquidate and dissolve the Company.
- 18.2 The appointment of a liquidator or a group of liquidators to oversee the liquidation procedures shall be determined by resolution of the Sole Shareholder.
- 18.3 Liquidator(s) will prepare the liquidation report, which contains an overall of economic standing of the Company, the steps of liquidation and the time needed for its completion and any other documents required for the liquidation process. The Sole Shareholder shall approve the final balance sheet, reports, any additional document and shall resolve on the termination of liquidation procedure and deregistration of the Company.

Article 19 **Final provisions**

- 19.1 These Articles of Association is prepared and signed in 3 (three) originals in English and translated into Albanian language. In case of

në valutë të huaj, shuma të cilat duhet të konvertohen, çdo muaj në monedhën vendase.

- 17.3 Në përputhje me Nenet 12.3 dhe 12.4, Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye, Ortaku i Vetëm mund të lërë peng kuotat e tij në Shoqëri si garanci, ose mund të vendosë të hipotekojë aktivet e Shoqërisë.

Neni 18 **Likuidimi**


- 18.1 Ortaku i Vetëm ka autoritetin për të likuiduar dhe të shpërndajë Shoqërinë.
- 18.2 Emërimi i një likuiduesi ose një grupi likuiduesish për të mbikëqyrur procedurat e likuidimit do të përcaktohet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 18.3 Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një gjendje të përgjithshme ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij dhe çdo dokument tjetër të kërkuar për procesin e likuidimit. Ortaku i Vetëm do të miratojë bilancin përfundimtar, raportet, çdo dokument shtesë dhe do të vendosë për përfundimin e procedurës së likuidimit dhe çregjistrimin e shoqërisë.

Neni 19 **Dispozitat përfundimtare**

- 19.1 Ky Statut është përgatitur dhe nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe të përkthyer në gjuhën Shqipe. Në rast

discrepancies between the two versions,
the English language version shall
prevail.

mospërputhjes ndërmjet dy versioneve, do
të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.




Signed on / Nënshkruar më 11.09.2026 from/ nga:


SOLE SHAREHOLDER / ORTAKU I VETËM

DIAVERUM AB

Represented by / Përfaqësuar nga


Simon Ottosson
Authorized Signatory




Emelie Lönnblad
Authorized Signatory



 **DIAVERUM**

Hyllie Boulevard
215 37 MALMÖ
Sweden

VAT: SE55914053

Notarius Publicus Malmö



I, Notary Public of the City of Malmö, Sweden, do herewith certify

that **Mr. Simon Ottosson**

and

Ms. Emelie Lönnblad

personally have signed their names on the attached document

and that they are authorized to sign jointly on behalf of **Diaverum AB**, reg.no. 559140-5344, as far as the records of the Swedish Companies Registration Office show on the date hereof.


Malmö, Sweden, this 11th day of September 2026

Ex officio notarii publici:

Kristian Jönsson
Notary Public of the City of Malmö, Sweden
Member of the Swedish Bar Association
Malmöhusvägen 1
SE-211 18 Malmö, Sweden
+46 40 12 01 25
reception@npmalmo.se



Exp. no. 268345



APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Country: Sweden

This public document

2. has been signed by Kristian Jönsson
3. acting in the capacity of Notary Public
4. bears the seal/stamp of the Notary Public of the City of Malmö.

Certified

5. in Malmö


6. the 11TH day of September 2026

7. by Nicklas Lång, Deputy Notary Public of the City of Malmö.

8. No. 26.8347.....

9. Seal/stamp:

10. Signature:



.....
.....

Notarius Publicus Malmö

Unë, Noteri Publik i Qytetit të Malmo, Suedi,
vërtetoj se

z. Simon Ottosson

dhe

znj. Emelie Lönnblad

kanë nënshkruar personalisht dokumentin bashkëngjitur
dhe se ata janë të autorizuar të nënshkruajnë bashkërisht në emër të
Diaverum AB, me nr. regjistrimi 559140-5344, nga sa rezulton nga të dhënat e
Zyrës Suedeze të Regjistrimit të Shoqërive në datën e këtij dokumenti.

Malmo, Suedi, më 11 Shtator 2026

Ex officio notarii publici:

[Nënshkrim i palexueshëm]

Kristian Jönsson

Noteri Publik i Qytetit të Malmo, Suedi

Anëtar i Dhomës Suedeze të Avokatisë

Malmohusvagen 1

S-211 18 Malmo

+46 40 12 01 25

reception@npmalmo.se

Exp.nr. 268345

[Vula]



Notarius Publicus Malmö



APOSTILE (Konventa e Hagës 5 tetor 1961)	
1. Shteti: Suedi	
Ky dokument publik	
2. Është nënshkruar nga Kristian Jönsson	
3. Në cilësinë e Noterit Publik	
4. Mbajtës i vulës/pullës së Noterit Publik të Qytetit të Malmo	
Vërtetuar	
5. Në Malmo	6. Më 11 Shtator 2026
7. Nga Nicklas Lang, Zëvendës Noteri Publik i Qytetit Malmo	
8. Numri • 268347	
9. Vula / pulla Vula / pulla	10. Nënshkrimi Nënshkrimi



Daniela Demri

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LORIANA A. ROBO**



V2026050250400099367

**DATE 15/09/2026
NR REP 5114**

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 15/09/2026, para meje Notere LORIANA A. ROBO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Daniela Demiri, atësia Myzafer, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, lindur më 23/11/1983, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035740962 dhe nr. personal I36123030B.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "Vertetim Nenshkrimi dhe Apostile te dokumentit Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqerise Diaverum Albania shpk", nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetoj nënshkrimin e përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
LORIANA A. ROBO**

